LIGJ
Nr. 13/2014

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 72, nënndarjet "i", "ii", "iii", "iv" dhe "v" të shkronjës "a" të pikës 1, ndryshohen si më poshtë:
"i) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e financave;

ii) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë;
iii) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore;
iv) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë;
v) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë.".

Neni 2

Në nenin 74, shkronja "ç" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:
"ç) propozon te ministri përgjegjës për çështjet e sigurimeve shoqërore ndryshimet në statusin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe ligjin e sigurimeve shoqërore;".

Neni 3

Në nenin 77 bëhen këto ndryshime:
1. Titulli bëhet "Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me ministrinë përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore".
2. Në pikën 1, fjalët "nëpërmjet Ministrisë së Financave" zëvendësohen me fjalët "nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore".
3. Në pikën 2, fjalët "do t'i paraqesë Ministrit të Financave" zëvendësohen me fjalët "do t'i paraqesë ministrit përgjegjës për çështjet e sigurimeve shoqërore".
4. Në pikën 3, fjalët "Ministri i Financave" zëvendësohen me fjalët "ministri përgjegjës për çështjet e sigurimeve shoqërore".
5. Në pikën 4, fjalët "Ministria e Financave" zëvendësohen me fjalët "Ministria përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore".

Neni 4

Në nenin 78, fjalët "ndërmjet Ministrisë së Financave" zëvendësohen me fjalët "ndërmjet ministrisë përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore".

Neni 5

Kudo në ligj fjalët "Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale" zëvendësohen me fjalët "ministria përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.2.2014

Shpallur me dekretin nr. 8506, datë 24.2.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani